



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë: 24.03.2026

Thirrje publike

Masa 4 Mbështetje financiare për akterët tjerë të zhvillimit socio-ekonomik rajonal

Nën Masa 4.1. Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile

UDHËZIMET PËR APLIKANTËT

Data e hapjes së thirrjes: 24.03.2026

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 24.04.2026

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
Qëllimi i Udhëzuesit.....	4
Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti).....	4
Objektivat e aplikimit	4
KUSH MUND TË APLIKOJ?.....	5
Grupi i synuar.....	5
Kriteret e aplikimit	5
Kushtet e zbatimit të aktiviteteve.....	6
Partneriteti me biznese private	6
Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike	6
Kërkesat specifike për aplikim.....	6
<i>Partnerët në zbatimin e projektit</i>	8
SI TË APLIKONI?	9
Hapat e aplikimit	9
Shpjegimi i procedurës.....	9
Formulari i projekt propozimit.....	9
Formulari i propozim buxhetit	10
VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE	10
DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA	11
Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen	11
Udhëzime për mënyrën e dorëzimit	12
AFAFTET E APLIKIMIT	12
Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit.....	12
PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT.....	12
Metoda e vlerësimit	13
Faza e vlerësimit procedural.....	13
Faza e vlerësimit të përmbajtjes.....	13
Faza e nënshkrimit të kontratave	13
Faza e implementimit.....	13
Raporti përfundimtar	13
Kriteret e vlerësimit	14
Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme	15
Shpenzimet e pranueshme	15
Shpenzimet e papranueshme.....	16
Informacione mbi mënyrën e njoftimit të aplikantëve të përzgjedhur	17

Lista rezervë	17
Ankesat.....	17
Dokumentacioni shtesë	18
NDIHMË DHE MBËSHTETJE	18
Kontakte për pyetje dhe ndihmë	18

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financa
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

HYRJE

Qëllimi i Udhëzuesit

Ky Udhëzues për Aplikant përcakton rregullat, kriteret, procedurat dhe afatet për aplikim në kuadër të Thirrjes Publike për Mbështetje Financiare të Organizatave Joqeveritare për vitin 2026.

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka hartuar këtë dokument me qëllim që të mbështesë projektet e OJQ-ve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, duke:

- promovuar zhvillimin e qëndrueshëm,
- bashkëpunimin rajonal,
- përfshirjen e komunitetit,
- sigurim të transparencës,
- trajtimin të barabartë të aplikantëve;
- qartësimin të procedurave të aplikimit dhe vlerësimit;
- rritjes së cilësisë së projekteve të propozuara;
- garantimit të përputhshmërisë me bazën ligjore në fuqi.

MZHR fton organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat fokusohen në zhvillimin socio-ekonomik rajonal, të aplikojnë për mbështetje financiare. Qëllimi është përmbushja e objektivave të MZHR-së dhe avancimi i politikave për zhvillim rajonal.

Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti)

Ky Udhëzues ofron mundësi për organizata që dëshirojnë të kontribuojnë në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Pjesëmarrësit mund të përfitojnë nga mbështetja financiare: trajnime, mundësi rrjetëzimi dhe mundësi për të implementuar projekte që kontribuojnë në qëllimet e përgjithshme të projektit.

Objektivat e aplikimit

Thirrja fokusohet në dy objektiva kryesore:

- I. Inkurajimi i të rinjve dhe grave për ngritjen e kapaciteteve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal, përfshirë:

- Identifikimin e fushave potenciale me ndikim zhvillimor rajonal dhe promovimin e tyre.
 - Trajnime dhe certifikime në Teknologji Informativë dhe Komunikim (TIK), dizajn grafik dhe inteligjencë artificiale.
 - Trajnime në ndërmarrësi, përfshirë hartimin e planeve të biznesit, financat dhe marketingun.
 - Zhvillimi i aftësive të buta, si lidershipi, komunikimi efektiv dhe mendimi kritik.
- II. **Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal, duke përfshirë:**
- Identifikimin dhe promovimin e mundësive të bashkëpunimit ndërmjet komunave, bizneseve dhe investitorëve.
 - Organizimin e aktiviteteve që promovojnë politikat e zhvillimit rajonal dhe nxisin pjesëmarrjen aktive të qytetarëve.
 - Zhvillimi i kapaciteteve lokale për krijimin e një ambienti të favorshëm për ndërmarrësi.
 - Promovimi i politikave të zhvillimit me fokus në prodhim dhe agjendën e gjelbër.
- III. **Përkrahja e Grave dhe të rinjëve ndërmarrës (Kjo objektive aplikohet vetëm për Organizatat të cilat mund të bashkë financojnë projektet e kësaj objektive dhe kanë bashkëfinancim të siguruar ose nga mjetet e veta ose nga burime të tjera si p.sh. donatorë, komuna, etj.) , duke përfshirë:**
- Identifikimin e ideve të reja inovative të ndërmarrësisë;
 - Ngritjen e kapaciteteve për ndërmarrësi të qëndrueshme;
 - Mbështetjen e ideve fillestare (startup)

KUSH MUND TË APLIKOJ?

Grupi i synuar

Grupi i synuar në këtë thirrje janë organizatat jo-qeveritare (OJQ) që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrje për aplikim. Kjo mund të përfshijë organizata të cilat janë aktive në fushën e zhvillimit socio-ekonomik dhe që kanë përvojë të mjaftueshme për të zbatuar projekte që synojnë ngritjen e kapaciteteve të individëve dhe grupeve të caktuara, si dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Kriteret e aplikimit

- Organizatat e shoqërisë civile mund të aplikojnë vetëm për një prej këtyre tri (3) objektive dhe mund të zgjedhin një ose më shumë nën-objektiva përkatës.

- Secila OJQ mund të aplikojë me një projekt të vetëm në kuadër të kësaj thirrje.

Kushtet e zbatimit të aktiviteteve

- Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që projekti të respektojë parimet e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit.
- Aktivitetet duhet të zhvillohen në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

Partneriteti me biznese private

- OJQ-të mund të krijojnë partneritete me biznese private për zhvillimin e programeve të trajnimeve, shfrytëzimin e hapësirave, demonstrime, etj.
- Nëse ka një partneritet të tillë, OJQ-të duhet ta përmendin atë në projekt propozimin e aplikantëve.

Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike

Për të qenë e pranueshme për këtë thirrje, organizata aplikuese duhet:

- Të jetë e regjistruar në përputhje me Ligjin për Lirinë e Asocimit në Organizata Jo-Qeveritare.
- Të jetë e pajisur me numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit.
- OJQ që aplikojnë për Objektivin II ose III duhet të kenë përvojë dhe aktivitete në fushën e zhvillimit socio-ekonomik dhe fushave të tjera të lidhura me këtë thirrje.
- Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet e tjera të detyrueshme, ose të jetë në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK, (nëse OJQ aplikuese është e regjistruar në vitin 2025 ose më herët)
- Mos të jetë në proces falimentimi, shuarjeje, procedura të mbledhjes së detyrueshme ose likuidimit.
- Mos të ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin aktivitet gjatë këtij viti. Aplikimi kërkon një deklaratë për shmangien e financimit të dyfishtë.
- Të dorëzojë një projekt propozim në përputhje me formularin e aplikimit të projektit dhe formularin e propozim buxhetit.

Kërkesat specifike për aplikim

Për të qenë i pranueshëm, aplikimi duhet të përmbushë këto kushte:

- Dorëzimi i projekt propozimit që përmban: qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë, dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar në thirrje.
- Projekt propozimi të shoqërohet me një propozim buxhet sipas formatit të përcaktuar.
- Dorëzimi i të dhënave për personelin kyç, duke përfshirë listën e punonjësve dhe CV-të, së bashku me deklaratën se ata pranojnë të punojnë për projektin me të cilin aplikohet.
- Dëshmia e hapsirave dhe asetëve tjera logjistike të dedikuara për veprimtarinë e OJQ-së.
- Dëshmia për prani të një ueb faqeje ose llogarie në rrjetet sociale (si: Facebook, Instagram, LinkedIn etj.) ku mund të shihen aktivitetet e OJQ-së.
- Në rast të bashkëfinancimit, aplikuesi duhet të sigurojë dëshmitë përkatëse.
- Dëshmia e realizimit të projekteve të ngjashme nëse aplikohet për aktivitete të ngjashme (si objektivi II-rë ose III-të).
- Organizatat që aplikojnë për objektivin dy (2) "Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal" duhet të kenë qenë të regjistruara për të paktën tre (3) vite para datës së publikimit të thirrjes dhe të kenë përfunduar së paku tre (3) projekte të ngjashme, ku dy (2) prej tyre duhet të kenë kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar.
- Organizatat që aplikojnë për objektivin tre (3) Përkrahja e Grave dhe të rinjve ndërmarrës duhet të kenë qenë të regjistruara për të paktën tre (3) vite para datës së publikimit të thirrjes dhe të kenë përfunduar së paku dy (2) projekte të ngjashme në përkrahjen e ndërmarrësisë, si dhe duhet të dëshmojnë bashkëfinancimin për numrin e projekt ideve që planifikojnë ti mbështesin. Një projekt ide për ndërmarrësit e rinj nga MZHR mund të përkrahet në shumën deri në 50% apo max 2,000.00 €, pjesa tjetër duhet të mbulohet nga OJQ. Shuma që përkrahet për këtë objektive nuk mbulon shpenzimet tjera përveç 50% të projekt ideve për ndërmarrësit e rinj.
- Prezantimi i lejes/licencës për ushtrimin e veprimtarisë, në rastet ku kërkohet leje/licencë nga autoritetet publike.

OJQ-të të cilat nuk mund të aplikojnë:

- OJQ-të që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara më lart, nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare ose do të refuzohen gjatë shqyrtimit.
- OJQ-të përfituese nga MZHR, që nuk kanë përfunduar projektet e tyre dhe nuk kanë dorëzuar raportin përfundimtar brenda viteve fiskale përfituese në 3 vitet e fundit, nuk do të kualifikohen për mbështetje financiare.
- Organizatat që kanë pasur probleme me bashkëpunimin, monitorimin ose përmbushjen e kërkesave të zyrtarit monitorues të MZHR-së në projektet e mëparshme mund të konsiderohen të papërshtatshme për përkrahje.

Partnerët në zbatimin e projektit

- Organizatat mund të aplikojnë në partneritet me OJQ të tjera, duke dorëzuar një deklaratë partneriteti.
- Kërkesat për partneritet duhet të bazohen në Rregulloren MF- Nr. – 04/2017, duke përfshirë përgjegjësitë për zbatimin e projektit.
- Partnerët duhet të bien dakord për rolin e tyre dhe të respektojnë parimet e praktikës së mirë në partneritet, duke përfshirë këto elemente:
 - Para dorëzimit të aplikimit tek ofruesi i mbështetjes financiare të gjithë partnerët duhet të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacioneve dhe të kuptojnë rolin e tyre në projekt.
 - Të gjithë partnerët autorizojnë aplikuesin, përmes një deklarate të përbashkët me shkrim, për t'i përfaqësuar ata në të gjitha marrëdhëniet me MZHR-në në kontekstin e zbatimit të projektit.
 - Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere do të takohen rregullisht dhe të punojnë së bashku për zbatimin e projektit, duke vlerësuar dhe shqyrtuar mënyrat për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive që mund të dalin gjatë implementimit të projektit.
 - Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e pasqyrave të përbashkëta përshkruese dhe financiare dhe aplikuesi në emër të të gjithë partnerëve paraqet ato tek MZHR;
 - Propozimi për ndryshim të mundshëm të partnerëve të projektit duhet të bëhet me marrëveshje në mes të partnerëve, për të cilën njoftohet MZHR përmes një deklarate të përbashkët pajtueshmërie të partnereve fillestar, ndërsa aplikuesi e dorëzon atë tek ofruesi i mbështetjes financiare.

SI TË APLIKONI?

Hapat e aplikimit

1. Kompletimi i dokumenteve të kërkuara.

Sigurohuni që të përgatiten dhe të plotësohen të gjitha dokumentet dhe informacionet që kërkohen sipas udhëzimeve të thirrjes për aplikim.

2. Përgatitja e projekt propozimit

Përgatitni një propozim të detajuar për projektin, që përfshin objektivat, aktivitetet, buxhetin dhe planin e zbatimit.

3. Kontrolli dhe verifikimi i aplikimi.

Kontrolloni që aplikimi dhe dokumentet janë të plotë dhe të sakta.

4. Formularët dhe materialet përcjellëse

Formularët dhe materialet e nevojshme mund të merren në ueb faqen e MZHR-së në këtë link: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,37>

5. Dorëzimi i aplikimit

Dokumentet e kompletuara mund të dorëzohen fizikisht në adresën e mëposhtme:

Arkivi/Shkrimorja e Ministrisë për Zhvillim Rajonal
Adresa: Ndërtesa e dytë e Qeverisë, ish-Pallati i Rilindjes,
Kati III
Prishtinë, Kosovë, 10000

Shpjegimi i procedurës

Formulari i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit të detyrueshëm. Ky formular përmban informacione të nevojshme lidhur me aplikuesin dhe partnerët, si dhe detaje mbi përmbajtjen e projektit për të cilin kërkohet financimi nga burimet publike.

Nëse formulari dorëzohet pa informacion të plotë mbi përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret parasysh. Formulari duhet të plotësohet në mënyrë elektronike dhe është e domosdoshme që të gjitha fushat e detyrueshme, të cilat shfaqen me simbolin (*), të plotësohen. Nëse këto fusha nuk plotësohen, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të shqyrtohet.

Formulari duhet të jetë i nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vuloset.

Formulari i propozim buxhetit

Formulari i propozim buxhetit është një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin. Ky formular përmban informacion të detajuar për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit që po propozohet për financim.

Nëse formulari nuk është plotësuar në mënyrë të plotë ose në formën e kërkuar, aplikimi do të refuzohet. Formulari duhet të plotësohet vetëm në format elektronik (me kompjuter), pasi ato të dorës nuk pranohen.

Për ta bërë formularin të vlefshëm, ai duhet të jetë i nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të jetë i vulosur.

VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE

Vlera totale e planifikuar për thirrjen është rreth 200,000.00 euro, e cila mund të rritet ose të ndryshojë në përputhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe kualitetin e aplikimeve. Shuma minimale dhe maksimale e mbështetjes për çdo objektiv të projektit janë të specifikuara si më poshtë:

- Projektet do të financohen deri në 100% të totalit të kostove të pranueshme të projektit. Aplikantët dhe partnerët potencialë kanë mundësinë të sigurojnë bashkëfinancim nga burime të tjera financiare, si burime publike ose private, për të mbështetur pjesë të tjera të projektit.
- Numri i OJQ-ve që mund të financohen përmes kësaj thirrje për Objektivin 1 dhe 2 është rreth 30, kurse për objektivin 3, maksimum dy OJQ. Ky numër mund të ndryshojë varësisht nga kualiteti i aplikimeve dhe vlerësimi i tyre nga komisioni përkatës.

Objektivat		Shuma minimale	Shuma maksimale
I.	Inkurajimi i të rinjve dhe grave për ngritjen e kapaciteteve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal	4,000.00€	6,000.00€
II.	Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal	6,001.00€	10,000.00€
III.	Përkrahja e grave dhe të rinjëve ndërmarrës (Kjo objective aplikohet vetëm për organizatat që kanë bashkëfinancim)	40,000.00€	60,000.00€

DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban formën e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- Formulari i projekt propozimit (F9).
- Formulari i propozim buxhetit (F10).
- Formulari i deklaratës së partneritetit *(nëse është e aplikueshme)* (F12).
- Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë (F11).
- Forma e deklarimit të projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit (2023, 2024, 2025) (F13).
- Formulari për deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të projektit (F14).
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së *(në të cilën përfshihet numri fiskal)*.
- Deklaratë vjetore për vitin 2025 *(nga ATK)*, nëse OJQ aplikuese është e regjistruar gjatë vitit 2025 ose më herët.
- Vërtetimi Tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik, të vlefshme në ditën e aplikimit, me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK, nëse OJQ aplikuese është e regjistruar gjatë vitit 2025 ose më herët *(Certifikata duhet nxjerr gjatë kohës sa është e hapur thirrja publike)*.
- Me rastin e aplikimit, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale *(Certifikata mbi dënimet penale mund të nxirret online në platformën [eKosova](#))*.
- Organizatave që aplikojnë për objektivin dy (2) të thirrjes "Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal", duhet t'i kenë plotësuar të paktën 3 vjet nga regjistrimi dhe të kenë së paku tre (3) referenca për projekte të realizuara, ku dy (2) prej tyre duhet të jenë projekte që kanë kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar *(shih kriteret e veçanta)*.
- Organizatat që aplikojnë për objektivin tre (3) Përkrahja e Grave dhe të rinjve ndërmarrës duhet të kenë qenë të regjistruara për të paktën tre (3) vite para datës së publikimit të thirrjes dhe të kenë përfunduar së paku tre (2) projekte të ngjashme në përkrahjen e ndërmarrësisë, si dhe duhet të dëshmojnë bashkëfinancimin për numrin

e projekt ideve që planifikojnë ti mbështesin. Një projekt ide për ndërmarrësit e rinj nga MZHR mund të përkrahet në shumën deri në 50% apo max 2,000.00 €, pjesa tjetër duhet të mbulohet nga OJQ. Shuma që përkrahet për këtë objektivë nuk mbulon shpenzimet tjera përveç 50% të projekt ideve për ndërmarrësit e rinj.

- Lista e punëtorëve së bashku me CV e tyre.
- Dëshmia e zyrave dhe aseteve tjera logjistike të dedikuara për veprimtarinë e OJQ-së.
- Dëshmia për prani të një ueb faqeje ose llogarie në rrjetet sociale (si: Facebook, Instagram, LinkedIn etj.) ku mund të shihen aktivitetet e OJQ-së.

Udhëzime për mënyrën e dorëzimit

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në Arkivin e MZHR në kopje fizike dhe të njëjtat të deponohen në USB.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje në USB.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "*Të hapet nga Komisioni Vlerësues*".

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

AFATET E APLIKIMIT

Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit

Afati për aplikim fillon me 24.03.2026 deri më 24.04.2026 në orën 16:00. Aplikantit do t'i lëshohet një dëshmi se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së thirrjes.

PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT

Vlerësimi i aplikacioneve do të realizohet në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, e cila përcakton kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të.

MZHR do të formojë një komision vlerësues në përputhje me këtë rregullore, i cili do të ketë përgjegjësinë për të shqyrtuar aplikacionet dhe për të verifikuar nëse ato plotësojnë kushtet formale të përcaktuara në thirrjen publike.

Metoda e vlerësimit

Aplikacionet e pranuara do të kalojnë përmes fazave të mëposhtme të vlerësimit.

Faza e vlerësimit procedural

- Komisioni vlerësues kontrollon të gjitha aplikacionet e pranuara për të verifikuar nëse ato i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.
- Pas kontrollit, komisioni përgatit dy lista:
 - Lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet për vlerësim të përmbajtjes së projekteve të tyre.
 - Lista e aplikantëve që nuk i plotësojnë kushtet dhe arsyeja e refuzimit do t'u dërgohet me shkrim.

Faza e vlerësimit të përmbajtjes

- Aplikantët që kalojnë fazën procedurale do të vlerësohen nga komisioni në përputhje me rregulloren dhe formularët përkatës të vlerësimit.
- Aplikantët e para kualifikuar do të ftohen të prezantojnë projekt propozimet e tyre, fizikisht ose online.
- Komisioni vlerësues ka të drejtën të rishikojë dhe të miratojë buxhetin e aplikantëve gjatë procesit të vlerësimit.
- Komisioni vlerësues përgatit listën preliminare të përfituesve.

Faza e nënshkrimit të kontratave

- Pas miratimit të aplikacioneve, do të nënshkruhen kontratat midis MZHR-së dhe aplikantëve të miratuar.

Faza e implementimit

- Pasi të jenë nënshkruar kontratat, do të fillojë faza e implementimit të projekteve.
- Afati i implementimit të projektit do të specifikohet në Kontratë.
- Përfituesi i projektit duhet të informojë Departamentin e Planifikimit dhe Koordinimit të Zhvillimit Rajonal (DPKZHR) mbi zbatimin e aktiviteteve të projektit së paku një javë para realizimit të aktivitetit. Mos informimi në kohë për zbatimin e aktiviteteve do të sjellë masa ndëshkuese.

Raporti përfundimtar

- Pas përfundimit të projekteve, një raport përfundimtar do të përgatitet dhe dorëzohet tek zyrtari monitorues. Mosdorëzimi i raportit brenda afatit të paraparë do të rezultojë në përfshirjen e OJQ-së përfituese në listën e zezë.

Kriteret e vlerësimit

Forma e Vlerësimit Kriteret e vlerësimit janë të ndarë në disa fusha të vlerësimit. Në çdo fushë të vlerësimit janë caktuar pikët në mes të 1 dhe 5, në përputhje me kategoritë e mëposhtme të vlerësimit: 1 = nuk është e mjaftueshme, 2 = mjaftueshëm, 3 = mirë, 4 = shumë mirë, 5 = shkëlqyeshëm.					
A. Kapaciteti institucional i organizatës (25 pikë)					
Kapaciteti dhe përvoja profesionale e organizatës dhe organizatës partnere (nëse ka) për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit.	1	2	3	4	5
Kapaciteti dhe struktura e menaxhimit të projektit nga organizata dhe organizata partnere (nëse ka) si: personeli, pajisjet dhe aftësia për të udhëheqë buxhetin e projektit.	1	2	3	4	5
Përvoja dhe njohuritë e stafit dhe ekspertëve (CV-të) e organizatës për implementimin e projektit	1	2	3	4	5
Struktura e qartë e menaxhimit të projektit dhe ndarja e përgjegjësisë, detyrimeve të anëtarëve të ekipit.	1	2	3	4	5
Angazhimi i grupeve të marginalizuara (<i>grave, PAK, komuniteteve</i>) apo vullnetarëve në zbatimin apo aktivitetet e projektit.	1	2	3	4	5
B. Rëndësia e projektit (40 pikë)					
Rëndësia e projektit për synimet, objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i objektivave të projektit të cilat janë realisht të arritshme	1	2	3	4	5
Aktivitetet janë të qarta, efektive, arsyeshme, kuptueshme dhe të zbatueshme	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i rezultateve dhe ndërlidhja e aktiviteteve me rezultatet e përcaktuara	1	2	3	4	5
Identifikimi i qartë i përfituesve të projektit dhe aktivitete që targetojnë përfituesit në mënyrë efektive	1	2	3	4	5
Identifikimi dhe angazhimi i akterëve relevant në implementimin e projektit dhe arritjen e rezultateve	1	2	3	4	5
Projekti ka definuar mirë nevojat dhe mënyrën se si nevojat do të adresohen përmes aktiviteteve	1	2	3	4	5
Janë paraparë rreziqet e mundshme dhe hapat për menjanimin e rreziqeve	1	2	3	4	5
C. Buxheti dhe shpenzimet (20 pikë)					
Kostot e projektit janë në përputhje me rezultatet që projekti parasheh të arrij	1	2	3	4	5
Kostot e projektit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara	1	2	3	4	5
Kostot e projektit janë të arsyeshme dhe të bazuara në çmimet e tregut	1	2	3	4	5

Kostot e projektit janë reale me kohëzgjatjen e pritshme të projektit	1	2	3	4	5
D. Ndikimi i projektit (15 pikë)					
Projekti është inovativ dhe kreativ në arritjen e objektivave	1	2	3	4	5
Projekti ndikon në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në fushën në të cilën aplikohet	1	2	3	4	5
Rezultatet e projektit janë të qëndrueshme	1	2	3	4	5
TOTAL	100 pikë				

Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme

Vetëm shpenzimet reale dhe të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit do të financohen. Këto përfshijnë:

- **Organizimi i aktiviteteve edukative dhe tryezave të rrumbullakëta:** Çdo aktivitet duhet të ketë të identifikuar llojin, çmimin e shërbimeve të ofruara dhe grupin e synuar të pjesëmarrësve.
- **Material shpenzues për realizimin e projektit:** Materialet e përdorura për zbatimin e aktiviteteve të projektit.
- **Shërbime grafike:** Përfshihen shërbimet si prepress, shtypja e fletushkave, broshurave, revistave, etj., duke specifikuar llojin, qëllimin, sasinë dhe çmimin për njësi të shërbimeve.
- **Shërbime reklamuese:** Këtu përfshihen shërbimet për reklamim në televizion, radio, mirëmbajtjen e faqeve të internetit, njoftimet në gazeta dhe materiale promovuese, duke përcaktuar llojin, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve.
- **Shpenzimet e përfaqësimit:** Përdorimi i fondeve për organizimin e aktiviteteve të projektit, duke specifikuar qëllimin dhe numrin e pritshëm të pjesëmarrësve.
- **Shpenzimet për paga dhe kompensime:** Paga e menaxherëve të projektit, kontraktorëve nga organizatat ose partnerët e jashtëm, duke specifikuar emrat, kompetencat dhe shumën mujore bruto të kompensimit për çdo person të angazhuar.
- **Shpenzimet për komunikim:** Shpenzimet e telefonit, internetit dhe të tjera, që nuk duhet të kalojnë 150 euro për periudhën e implementimit të projektit.

- **Shpenzimet për prokurimin e pajisjeve:** Këtu përfshihen shpenzimet për blerjen e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit, me specifikimin e llojit dhe shumës së pajisjeve.
- **Shpenzimet e udhëtimit:** Shpenzimet për transport, akomodim dhe meditje për organizimin e aktiviteteve, duke specifikuar numrin e pjesëmarrësve, destinacionin, qëllimin e udhëtimit dhe llojin e akomodimit dhe transportit, si dhe kohëzgjatjen e udhëtimit.
- **Kostot e derivateve:** Këto nuk duhet të kalojnë 5% të shumës totale të projektit të financuar.
- **Kostot e paparashikuara:** Shpenzimet e paparashikuara nuk duhet të kalojnë 5% të shumës totale të projektit të financuar.

Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet që nuk mund të mbulohen përfshijnë, për shembull:

- Investimet në kapital ose kredi për investime, si dhe fonde garancie.
- Blerja e pajisjeve, mobileve dhe punë të vogla ndërtimore, nëse shuma e këtyre shpenzimeve kalon 10% të kostove totale të pranueshme të projektit.
- Shpenzimet e interesit për borxhin.
- Gjjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet që lidhen me procedurat gjyqësore.
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare).
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera financiare.
- Kostot që janë financuar tashmë nga burime publike ose shpenzime të tjera të mbuluara nga burime të ndryshme gjatë periudhës së implementimit të projektit.
- Blerja e pajisjeve të përdorura, makinerive dhe mobileve.
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare).
- Donacionet bamirëse.
- Kredi të dhëna për organizata ose individë të tjerë.
- Shpenzimet që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat dhe përmbajtjen e projektit.

Informacione mbi mënyrën e njoftimit të aplikantëve të përzgjedhur

Pas përfundimit të vlerësimit, rezultatet paraprake do të publikohen si vendim në ueb faqen e MZHR-së dhe do të njoftohen me shkrim të gjithë aplikantët.

Rezultatet paraprake do të konkretizohen me Kontratë, përveç në rast se paraqitet ndonjë ankesë e bazuar dhe e konfirmuar nga Komisioni i Ankesave ose nuk e kalojnë fazën e tretë (verifikuese në terren). Pra, nëse paraqitet ankesa, rezultatet paraprake do të bëhen përfundimtare pasi të trajtohen ankesat e aplikantëve.

Lista rezervë

Aplikimet me pikët më të larta do të përzgjidhen si përfitues deri në shpenzimin e plotë të buxhetit në dispozicion.

Pas shpenzimit të buxhetit, aplikantët që kanë arritur së paku 50 pikë dhe më shumë, do të mbeten në listën e pritjes/rezervë. Aplikantët do të renditen sipas pikëve që kanë fituar, duke filluar nga ata me më shumë pikë deri tek ata me më pak pikë të fituara.

Lista rezervë do të mbetet e vlefshme për vitin fiskal 2026.

Ankesat

Aplikantët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të Komisionit Vlerësues pranë Komisionit të Ankesave, në rastet e mëposhtme:

- **Ankesë për diskualifikim:** Nëse aplikimi është refuzuar për shkak të mos përmbushjes së kriterëve formale gjatë vlerësimit procedural.
- **Ankesë për ofrimin e mbështetjes financiare:** Nëse nuk është aprovuar mbështetja financiare ose nëse ekziston pakënaqësi në lidhje me vendimin e ofrimit të mbështetjes financiare.

Të gjitha ankesat në lidhje me thirrjen publike duhet të dorëzohen në kopje fizike në arkivin e MZHR-së, nga aplikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, jo më vonë se 29.05.2026.

Komisioni i Ankesave do të shqyrtojë dhe do të marrë vendimin për ankesat deri më 10.06.2026, në përputhje me rregulloren përkatëse.

Dokumentacioni shtesë

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, MZHR do të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët, i cili përfshin:

- Certifikata nga Gjykata Komerciale që personi juridik nuk është në falimentim.
- Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të OJQ-së (*i cili duhet të jetë nxjerrë gjatë periudhës kur thirrja publike është ende e hapur*).

DPKZHR do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë. Nëse aplikanti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda kohës së caktuar (jo më pak se 10 ditë), aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse, konstatohet se disa aplikantë nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara nga thirrja publike, ata nuk do të merren parasysh për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë ftohen bazuar në renditjen e tyre dhe pasi të jetë kryer kontrolli i dokumenteve plotësuese nga DPKZHR, si dhe të konfirmohet nga DBF që ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

NDIHMË DHE MBËSHTETJE

Kontakte për pyetje dhe ndihmë

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike në adresën e mëposhtme: dpkzhr@rks-gov.net jo më vonë se 14.04.2026. Përgjigjet do të kthehen në formë elektronike dhe do të publikohen në faqen zyrtare të MZHR-së më datë 17.04.2026.